**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK**
**GRAMSH**

Nr 4023/12 prot Gramsh, më 02/07/2018

# VENDIM

Nr. 47, datë 22.06.2018

Për

"Miratimin e kërkesës së Bashkise Gramsh, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimi e ndihmes finanaciare për familjen e Z.Idajet Skora, banesa e të cilit është dëmtuar nga rrë shqitja e tokë s, nga buxheti i bashkisë dhe nga buxheti i vitit 2018 ne Ministrin e Mbrojtjes, program "Emergjenc civile"

Në mbështetje të ligjit nr.8756,datë 26.03.2001,"Për emergjencat civile",neni 2,pika 5,neni 16,17,32,shkronja a,të VKM-së nr.329,datë 16.05.2012,"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"kreu i III-të,të ligjit nr.139/2015,datë 17.12.2015,"Për vet qeverisjen vendore" neni 8 pika 2,neni 9 pika 1/1b.

## VENDOSI:

1. Të miratoj kërkesën e Bashkisë Gramsh për mbështetje financiare shtetasit Idajet Skora për dëmtimin e banesës së tij nga rrë shqitja e tokës.
2. Të miratoj dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Gramsh.
3. Ti akordoj familjes së shtetasit Idajet Skora, ndihmën emergjente ne vlerën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë nga buxheti i bashkisë Gramsh, fondin e emergjencave civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2018
4. Të paraqesë dokumentin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për shkakë të pamundesisë së bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
5. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Idajet Skora, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.
6. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Idajet Skora, banesa e të cilit është dëmtuar nga rrë shqitja e tokë s.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

**Sekretari i Këshillit të Bashkisë**
**Astrit DUZHA**

**Kryetari i Këshillit të Bashkisë**
**Shkëlqim HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA GRAMSH

Konc.Dak.A.Duzha
Pranoi. SH.Hoxha
Miratoi.SH.Hoxha
Dosia______
Ekzemp. 5